

# Mirë se erdhët në Gjermani!

Informacione të rëndësishme për fillimin e punës në Gjermani



**Bundesagentur für Arbeit**

*Make it in Germany*

Working in Germany: the official website  
for qualified professionals

## Mirë se erdhët në Gjermani!

**Jemi të kënaqur që keni gjetur një vend pune në Gjermani dhe ju urojmë shumë sukses në ushtrimin e punës suaj të re. Këtu ju gjeni përgjigje ndaj pyetjeve të shpeshta dhe të rëndësishme që mund të lindin kur fillohet një punë e re në Gjermani<sup>1</sup>.**

### **Cilat veçori të veçanta zbatohen për kohën e punës në Gjermani?**

Si rregull, kontrata e punës përmban të dhëna të detyrueshme lidhur me kohën e punës. Në Gjermani, një vend pune me kohë të plotë përbëhet më së shumti midis 35 dhe 40 orësh në javë. Sipas ligjit të punës nuk lejohet të punohet më shumë sesa 48 orë në javë. Një rritje deri në 60 orë në javë është e mundur nëse koha mesatare e punës prej 8 orësh në ditë nuk tejkalohet brenda një periudhe prej gjashtë muajsh. Normalisht, të punësuarit punojnë nga e hëna deri të premten. Me ligj lejohet puna në të gjitha ditët e punës (të hënën deri të shtunën), si dhe punë natën dhe me turne. Në disa sektorë, p.sh. në shëndetësi, puna lejohet edhe të dielave dhe në ditë festash. Në shumë sektorë është e parashikuar me ligj që fillimi, fundi dhe kohëzgjatja e punës të shënohen ose të regjistronen teknikisht. Nëse keni pyetje se si do të zbatohet me përpikëri kjo në kompaninë tuaj, drejtojueni partnerit të kontaktit (partneres së kontaktit) në kompani.

### **Sa pushime në vit mund të bëj?**

Sipas ligjit federal për pushimet, si rregull, keni të drejtë për pushime dhe ditë festash të paguara. Leja për pushime përmban të paktën 4 javë në vit. P.sh., nëse punoni 5 ditë në javë, këto janë të paktën 20 ditë pushimesh në vit. Nëse në kompaninë tuaj zbatohet e ashtuquajtura marrëveshje kolektive, mund të ndodhë që të jetë rënë dakord për më shumë ditë pushimesh dhe, prandaj të keni të drejtën për më shumë pushime. Për ditët kur do të bëni pushimet tuaja duhet të bini dakord në kohën e duhur me kompaninë tuaj.

### **A do të paguhem në mënyrë të arsyeshme? Ku i marr paratë?**

Rroga mund të jetë e ndryshme në varësi të kualifikimit, sektorit, rajonit dhe madhësisë së kompanisë. Një vështrim të përgjithshëm mbi të ardhurat mesatare në profesionin tuaj e merrni, për shembull, nëpërmjet Atlasit të pagesës të Agjencisë Federale të Punësimit. Që nga janari 2021, paga mini-

male ligjore në fuqi për të gjithë Gjermaninë është 9,50 Euro (bruto) në orë dhe nga korriku 2021 do të jetë 9,60 Euro (bruto). Paga e punës zakonisht paguhet jo më vonë sesa data 15 e muajit vijues. Por, në kontratën e punës mund të bëhen edhe marrëveshje të tjera mes jush dhe kompanisë.

### **Çfarë ndodh nëse jam sëmurë?**

Nëse sëmureni dhe si pasojë nuk mund të punoni, jeni të detyruar të njoftoni menjëherë kompaninë për paaftësinë për të punuar dhe kohëzgjatjen e saj të pritur. Nëse paaftësia për punë zgjat më shumë se tri ditë kalendarike, duhet t'i paraqisni kompanisë jo më vonë sesa dita vijuese e punës një vërtetim mjekësor për paaftësi për punë dhe kohëzgjatjen e pritur të saj. Kompania ka të drejtë ta kërkojë paraqitjen e vërtetimit mjekësor edhe më herët (për këtë lexoni në kontratën tuaj të punës ose konsultohuni me kompaninë tuaj). Nëse paaftësia për punë zgjat më shumë sesa është përcaktuar në vërtetimin mjekësor, punëmarrësi/punëmarrësja është i/e detyruar të paraqesë një vërtetim të ri mjekësor. Punëmarrësit/punëmarrëset objekt të sigurimit social të detyrueshëm janë të siguruar në Gjermani në sigurimet shëndetësore dhe marrin shërbimet e sigurimit ligjor. Ju dhe kompania juaj paguani në mënyrë proporcionale çdo muaj kontribute për sigurimin e pensionit, të papunësisë, sigurimin shëndetësor dhe të kujdesit, që zbriten direkt nga paga juaj bruto dhe nuk ju paguhen. Nëse jeni të punësuar në kompaninë tuaj me shumë se katër javë dhe sëmureni, kompania juaj vazhdon të paguajë pagën tuaj për gjashtë javë. Pas kësaj merrni pagesë si i sëmurë nga sigurimi shëndetësor.

### **Sa zgjat kontrata ime e punës? Çfarë ndodh në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës?**

Në shumë raste, kontratat e punës lidhen (fillimisht) të përkohshme. Nëse merrni një kontratë të përkohshme, atëherë në kontratë duhet të specifikohet afati i kohëzgjatjes. Shpesh bihet dakord edhe për një periudhë prove, e cila zakonisht zgjat gjashtë muaj. Brenda kësaj periudhe, ju ose kompania mund ta zgjidhni kontratën e punës brenda një afati të shkurtuar. Pas periudhës së provës të dakordësuar zbatohen afate ligjore për zgjidhjen e kontratës dhe mbrojtja ligjore ndaj zgjidhjes së kontratës. Zgjidhja e kontratës mund të bëhet nga të dyja palët. Ajo duhet të formulohet me shkrim dhe të nënshkruhet (jo me email). Deri në skadimin e afatit të zgji-

---

<sup>1</sup> Ju lutemi vini re se këtu bëhet fjalë vetëm për një përpilim informacionesh të përgjithshme. Një këshillim individual sipas ligjit të punës nuk mund të bëhet në këtë pikë.

dhjes së kontratës, si rregull, marrëdhënia e punës vazhdon, kjo do të thotë se deri në atë moment ekziston detyrimi për t'u paraqitur në punë. Në rastin e kontratës së punës së përkohshme, marrëdhënia e punës përfundon pa njoftim paraprak në datën e caktuar në kontratë.

### **Çfarë mund të bëj nëse dua ta lë vendin tim të punës dhe kompania më kërkon të paguaj shpenzimet e bëra në lidhje me rekrutimin tim nga jashtë shteti?**

Agjencia Federale e Punësimit përqipet brenda mundësive të saj që në rastin e planeve të saj, veçanërisht në rastin e marrëveshjeve bilaterale të rekrutimit me vende partnere për marrjen e punëtorëve të kualifikuar nga jashtë shteti, që kompanitë të heqin dorë nga klauzolat e besnikërisë së biznesit me detyrimet e rimbursimit. Por, rimbursimi i kostove të kompania mund të lejohet në disa raste. Një rimbursim i tillë i nënshtrohet gjithmonë kushteve: duhet të ketë një marrëveshje për rimbursim, e cila është specifikuar në kontratën e punës ose në një marrëveshje shtesë. Përveç kësaj, mund të kërkohej të rimburohen vetëm ato shpenzime të bëra për formimin tuaj profesional të mëtejshëm. Njëkohësisht duhet të merret parasysh se sa kohë ka zgjatur tashmë kontrata juaj e punës. Çdo rast është i ndryshëm, prandaj çdo situatë duhet të shqyrtohet individualisht. Në raste të tilla ju mund të merrni mbështetje, për shembull, nga sindikatat ose avokatët/avokatet. Nëse lindin shpenzime për këtë, duhet t'i paguani vetë.

### **Kush mund të më ndihmojë kur kam pyetje? Ku mund të marr mbështetje?**

Linja telefonike e Ministrisë Federale të Punës dhe Çështjeve Sociale mund t'ju ofrojë informacione dhe të dhëna mbi temën "E drejta e punës". Ajo arrihet nga e hëna deri të enjten në numrin e telefonit **030/221 911 004**. Përveç kësaj, në faqen e zyrës për trajtimin e barabartë të punonjësve të BE-së gjeni një përmbledhje të të gjitha zyrave këshilluese në Gjermani: ➔ **www.eu-gleichbehandlungsstelle.de**. Të filtruar sipas gjuhës dhe temës, ju mund të kërkonit atje zyrën e duhur këshilluese. Ato ju këshillojnë falas. Fuqitë punëtore nga vendet e treta, domethënë nga shtetet që nuk janë anëtare të BE-së, marrin këshillim personal edhe nëpërmjet programit "Faire Integration" (integrim i drejtë). Informacione për këtë dhe për të drejtat dhe detyrimet në jetën e punës i gjeni në:

➔ **www.faire-integration.de**.

Përveç kësaj, ju mund të merrni mbështetje dhe këshillim për çështje dhe probleme sipas ligjit të punës nga sindikatat ose avokatët/avokatet, para së gjithash nga avokatët e specializuar për të drejtën e punës. Shpenzimet për këshillimin nga avokatët duhet t'i paguani vetë.

### **Ku mund të gjej informacione të mëtejshme?**

Informacione të mëtejshme për të drejtat dhe detyrimet tuaja i gjeni, për shembull, në faqen e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Gjermanisë si dhe në faqet e internetit të disa sindikatave. Në faqen

➔ **www.make-it-in-germany.com** nëpërmjet linjës direkte **+49(0)30-1815-1111** ose përmes bisedës me tekst janë në dispozicion kanale të tjera informacioni për pyetjet tuaja.

Për pyetje – edhe për këtë fletëpalosje – **Qendra virtuale e mirëseardhjes së zyrës qendrore për ndërmjetësimin jashtë shteti dhe të specializuar (Virtuelles Welcome Center)** e Agjencisë Federale të Punësimit është në dispozicionin tuaj në gjermanisht dhe anglisht:

☎ **+49 (0)228 713-1313**

✉ **zav@arbeitsagentur.de**

🌐 **www.zav.de**

**Herausgeberin**

Bundesagentur für Arbeit,

90327 Nürnberg

Februar 2021

[www.arbeitsagentur.de](http://www.arbeitsagentur.de)



Einfach QR-Code mit  
Smartphone scannen.